



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:041819

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05758062

C.nr.274/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala dhe me bashkëpunëtorin profesional Burim Geci, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.L, të cilin sipas autorizimit më shkrim i përfaqëson avokat V.I, avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës K.M-DKA, të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson L.Z, avokat në Prishtinë. Objekt kontesti “*Kompensim e te ardhurave nga marrëdhënia e punës*”. Vlera e kontestit për të gjithë paditësit është ... Euro. Jashtë seancë gjyqësore, datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË POHIMIT

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit M.L, si e bazuar, dhe;
- II. DETYROHET e paditura K.M, që paditësit M.L, t’ia paguajë kompensimin e te ardhurave nga marrëdhënia e punës, dhe atë:
 - për 116 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga .. euro), t’ia paguajë shumën e tërësishme prej ... Euro;
 - në emër të kompensimit të inflacionit në pagë, për periudhën nga data 30.05.2019 deri më 31.12.2019, në lartësi prej 2.7 për qind të pagës bazë, shumën e tërësishme prej ... Euro, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 30.12.2020, në lartësi prej 0.2 për qind të pagës bazë, shumën prej ... Euro.
 -
- III. DETYROHET e paditura që paditësit, shumat e gjykuara sikurse në pikën II të dispozitivit, të paguaj edhe kamatë ligjore prej 8 për qind, e cila do të llogaritet nga data

palës kundërshtare, t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore, Gjykata ka marrë për bazë vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, rrjedhimisht Gjykata duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej .. euro dhe taksës gjyqësore shumë prej .. Euro, përkatësisht shumë e përgjithshme .. Euro.

Prandaj, gjykata bazuar ne arsyet e cekura me larte si dhe duke u bazuar ne nenin 148 te LPK, vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.274/2022, datë 30.05.2024

GJ Y Q T A R I

Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.